



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:058396

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05755690

KE.nr.2596/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia Pyjore e Kosovës – Drejtoria Koordinuese në Mitrovicë, me seli në Mitrovicë, rr. “Agim Hajrizi”, objekti i ish-shtëpisë së mallrave “LUX” kati III, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.M., kundër të paditurit “Nic Hollding” me numër të regjistrimit të biznesit 80099436, me seli në Milloshevë, Komuna e Obiliqit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Bajram Morina, avokat nga Gjakova, me objekt kontesti, kompensim dëmi, vlera e kontestit 12,793.52€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 17.05.2023, në prezencë të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datën 30.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia Pyjore e Kosovës – Drejtoria Koordinuese në Mitrovicë, dhe DETYROHET i padituri “Nic Hollding” që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar si pasojë e prerjes së masës drunore dhe humbjes së shtimit të vëllimit të saj për periudhën 25 vjeçare t’ia paguaj shumën prej 2,417.07€ (dy mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë euro e shtatë cent) me kamatë ligjore sipas lartësisë që paguhet si për mjetet të depozituara në bankë pa destinim të caktuar për një vit, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë, me datë 28.02.2013, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
- II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia Pyjore e Kosovës – Drejtoria Koordinuese në Mitrovicë, përtej shumës së gjykuar në dispozitivin I të këtij Aktgjykimi

dhe atë për shumën prej 10,376.45€ (dhjetëmijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro e dyzet e pesë cent).

### III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

### 1. Çështja gjyqësore dhe pretendimet e palëve

Paditësi Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) – Agjencia Pyjore e Kosovës (APK) – Drejtoria Koordinuese në Mitrovicë, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri me datë 28.02.2013 ka paraqitur padi ndaj të paditurit “Nic Holding” me kërkesën për kompensimin e dëmit. Sipas padisë, paditësi thekson se ka dhënë në shfrytëzim të përkohshëm tokën pyjore për eksploatimin e gurit gëlqeror dhe mineraleve të tjera në sipërfaqe prej 04ha, 07ari e 27m<sup>2</sup>, e cila gjendet në Zonën Kadastrale Strovç, Komuna e Vushtrrisë nr.P-70202063-01014-0, fletë posedimi numër 93, pjesa e ngastrës kadastrale 101400 në vendin e quajtur “Kungullore” me kulturë mal klasa 3, me ç ‘rast midis palëve ndërgjyqëse është lidhur Kontrata Ref-KE-469/2009 e datës 20.07.2009. Sipas padisë së paditësit, i padituri ka dështuar që të përmbush obligimin që rrjedhë nga neni 5 i kësaj kontrate respektivisht pagesën e qirasë dhe ka bërë vetëm një pagesë për muajin janar 2011, andaj Kryeshefi Ekzekutiv i APK-së ka nxjerr vendim për shkëputje të kontratës, për shkak të mos përmbushjes së obligimeve kontraktuale. Me ç ‘rast sipas paditësit është bërë vlerësimi i dëmit të shkaktuar me rastin e kryerjes së punëve përgatitore për vendosjen e mjeteve për gurëthyes, ku ka rezultuar se dëmi i shkaktuar me rastin e shkulljes së drunjëve ka qenë 5,663.52€, për planin e ri të kultivimit shuma prej 2,350.00€ dhe shpenzimet për mirëmbajtjen në shumë prej 4,780.00€, ndërsa në shumë të tërësishme 12,793.52€.

Gjatë shqyrtimeve gjyqësore në rigjykim, përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë të ushtruar nga ana e APK kundër operatorit ekonomik “Nic Holding” për dëmin e shkaktuar në vlerën prej 12,793.52€, duke shtuar se bazuar në të gjitha vlerësimet e komisioneve profesionale është vërtetuar se dëmi i shkaktuar saktësisht në vlerën prej 12,793.52€, prandaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi si të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit.

I padituri përmes përgjigjes në padi ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, pasi që sipas të paditurit, për faktin se nuk janë paraqitur prova me të cilat vërtetohet saktësisht periudha kohore për të cilën paditësi kërkon

pagesën e qerasë. Po ashtu, thekson se paditësi ka paraqitur kërkesën e tij pas kalimit të afatit ligjor. Tutje, ka theksuar se i padituri fare nuk e ka shfrytëzuar pronën e dhënë me qera andaj për këtë arsye i padituri konsideron se nuk ka detyrim të paguaj shumën e precizuar. Më tej ka kontestuar edhe cilësinë e personit juridik në qarkullimin juridik, andaj nuk mund të jetë palë legale në procedurë.

Gjatë shqyrtimeve gjyqësore në rigjykim, i padituri përmes përfaqësuesit të autorizuar ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, deklarimeve të thëna gjatë shqyrtimit gjyqësor duke kundërshtuar plotësisht bazën juridike të kërkesëpadisë. Ka shtuar se pas administrimit të provave është vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pa bazuar për shkaqet e përmendura në përgjigjen në padi, në të dy ankesat drejtuar Gjykatës së Apelit si dhe për shkaqet e pretenduara në seancat gjyqësore të mbajtura gjerë më tani. Andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyroj paditësin që të paditurës të ja kompensoj të gjitha shpenzimet procedurale në shumë të përgjithshme prej 2,299.00€ dhe këtë për përgjigje në padi shumë prej 208.00€, për përpilimin e dy ankesave për Gjykatën e Apelit në shumë prej 416.00€, për përfaqësim në pesë seanca gjyqësore në shumë të përgjithshme prej 1,325.00€ duke kalkuluar një seancë në shumë prej 270.40€ si dhe për ekspertizë shumë prej 350.00€.

Lidhur me këtë çështje kontestimore ka vendosur fillimisht Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri me Aktgjykimin C.nr. 159/13 të datës 26.09.2017 me të cilin ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka obliguar të paditurin që paditësit ti paguaj shumën prej 12,793.52€ ndërsa ka refuzuar kërkesën e paditësit për kompensimin e dëmit për vlerën prej 6,181.32€. Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin AC.nr. 4717/17 të datës 22.04.2020 ka aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurit dhe ka prishur Aktgjykimin C.nr. 159/13 të datës 26.09.2017 lidhur me pjesën aprovuese ndërsa pjesa refuzuese ka mbetur e pashqyrtuar për shkak të mos paraqitjes së ankesës.

Në rigjykim dhe rivendosje Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri, përmes Aktgjykimit C.nr.295/20, të datës 06.10.2022 kishte aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke detyruar të paditurin që paditësi ti kompensoj dëmin në lartësi prej 2,417/07€, ndërsa kishte refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e shumës prej 10,376.45€, mirëpo ky aktgjykim ishte anuluar nga Gjykata Komerciale e Kosovës përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.1226/2022 të datës 06.10.2022, me të cilin çështja ishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

## *2. Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar*

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore dhe në bazë të propozimeve të palëve ndërgjyqëse, gjykata në rigjykim gjatë procedurës së provave bëri administrimin e këtyre provave: Raport nr. 136 i datës 06.06.2012, Aktvendim nr. Ref.Ke87/12 i datës 16.02.2012 për shkëputjen e kontratës ref.ke.469/09 i datës 20.07.2009, Kontratë për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës pyjore Ref.Ke.469/09 i datës 20.07.2009, Deklaratë nr. 151 i datës 26.11.2010, Fletëpagesë nr. 008856, Vendim nr. Ref. Ke -148/13 i datës 19.03.2013, Raport i vlerësimit profesional për vlerësimin e dëmit të drurëve të prerë i datës 26.07.2021.

Gjykata pas vlerësimit të deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka konstatuar këtë gjendje faktike.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se me datën 20.07.2009, paditësi dhe i padituri kishin lidhur Kontratë për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës pyjore Ref.Ke.469/09, objekt i së cilës kishte qenë dhënia në shfrytëzim të përkohshëm e tokës pyjore për eksplotimin e gurit gëlqeror dhe mineraleve të tjera në sipërfaqe prej 04 ha, 07 ari e 27m<sup>2</sup>, e cila gjendet në Zonën Kadastrale Strovç, Komuna e Vushtrrisë nr.P-70202063-01014-0, fletë posedimi numër 93, pjesa e ngastrës kadastrale 101400 në vendin e quajtur “Kungullore” me kulturë mal klasa 3, me afat vlefshmërie të kontratës 5 vjet.

Nga Raporti nr. 136 i datës 06.06.2012, gjykata konstatoi se paditësi ka hartuar një raport lidhur me dëmet e shkaktuara ashtu ishte konstatuar se i padituri kishte bërë shkuljen (pastrimin) e drunjtëve të llojit quergus ceris, queris conferta dhe fraxinus omus në sipërfaqe prej 2ha, po ashtu në vendin e ngjarjes janë konstatuar gjurmët e vrimave të shpimeve e si rezultat i të gjithave ishte konstatuar se lartësia e dëmit të shkaktuar si pasojë e këtyre ndërhyrjeve është 5,663.52€.

Nga Aktvendim nr. Ref.Ke87/12 i datës 16.02.2012 për shkëputjen e Kontratës Ref.Ke.469/09 i datës 20.07.2009, gjykata konstatoi se paditësi ka nxjerr vendim për shkëputjen e Kontratës për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës pyjore Ref.Ke.469/09, për shkak të mos përmbushjes së obligimeve, dhe atë në emër të qirasë së tokës pyjore shumë prej 515.11€ kësti mujor, x12 muaj në vlerë totale prej 6,181.32€, në emër të vëllimit të masës drusore të humbur, shumë prej 30,907.00€ dhe në emër të Planit të ri kultivimit të tokës pyjore, shumë prej 243.625.00€, gjithsej në shumë prej 280,713.13€.

Me Vendimin Ref. KE-148/13 të datës 19.03.2013 gjykata ka konstatuar se paditësi ka refuzuar kërkesën e të paditurit për vazhdimin e Kontratës Ref.Ke.469/09 i datës 20.07.2009 me arsyetimin se i padituri nuk ka përmbushur obligimet e përcaktuara në kontratë dhe në raportin e vlerësimit të dëmit.

Me qëllim të vlerësimit të lartësisë së dëmit të shkaktuar nga i padituri, gjykata ka bërë nxjerrjen e provës përmes ekspertizës nga lëmia pylltarisë dhe për ekspert ka caktuar z. Q.K., i cili me datë 26.07.2021 ka hartuar Raportin e vlerësimit profesional për vlerësimin e dëmit të drurëve të prerë. Eksperti nga lëmia e pylltarisë ka konstatuar se sipërfaqja totale ku vërehen gjurmë të shpimeve dhe largim i pjesshëm i drurëve kryesisht për depërtimin e makinerisë për shpime është 1 ha, 21 ari e 30 m<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja e zhveshur (tokë pyjore) ku nuk ka pasur shkulje të drurëve e as dëmtim të tyre për arritjen e makinerisë për shpime është 50 ari ashtu që sipërfaqja në të cilën ka pasur pjesërisht dëmtim dhe prerje të drurëve pyjor është 0ha 71 ari e 30m<sup>2</sup>. Lidhur me këto matje, eksperti ka konstatuar se gjithsej vlera e dëmit të shkaktuar nga i padituri është 2,417.07€ dhe atë 449.19€ për vlerën e masës drunore, 898.38€ për vlerën e humbjes së rritjes (shtimit) vjetor të masës drunore për periudhën 25 vjet dhe 1,069.50€ për ripyllëzimin.

### 3. Baza ligjore

Nga faktet e vërtetuara, Gjykata gjeti se në rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat e Ligjit Nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, nenit 13 par. 1 nën par. 1.1. i cili përcakton se: *“1. Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre;”*. Si dhe Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Gazeta Zyrtare e ish RSFJ nr.29/78 (i aplikuar në kohën e krijimit të raportit juridik të palëve)

Neni 154 par. 1 i LMD përcakton se: *“Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”* si dhe neni 155 i cili përcakton se: *“Dëmi është pakësim i mjeteve shoqërore, respektivisht i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe parandalimi i shtimit të tyre (përfitimi i munguar), si dhe shkak i tjetrit të dhimbjes ose të frikës fizike apo psikike (dëmi jo material).”*

Po ashtu neni 185 par. 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi”* ndërsa par. 2 përcakton se *“Në qoftë*

*se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të jap kompensim në të holla”, si dhe par. 3 “Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që ta bëjë këtë personi përgjegjës, gjykata do të caktoj që ai t’ia paguajë dëmtuesit shumën përkatëse në të holla për efekt të kompensimit të dëmit” si dhe par. 4. “Gjykata do ti gjykojë dëmtuesit kompensimin në të holla kur ai e kërkon këtë me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e justifikojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme”.*

Sa i përket kamatës ligjore vije në zbatim dispozita nga nenin 277 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gazeta Zyrtare e ish RSFJ nr.29/78.

#### *4. Vlerësimet e gjykatës*

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, për faktin se paditësit si pasojë e mos përmbushjes së kontratës i është shkaktuar dëm në lartësi prej 2,417.07€ dhe atë sipas raportit të vlerësimit profesional për vlerësimin e dëmit të drurëve të prerë i datës 26.07.2021, dëmi prej 449.19€ për vlerën e masës drunore, 898.38€ për vlerën e humbjes së rritjes (shtimit) vjetor të masës drunore për periudhën 25 vjet dhe 1,069.50€ për ripyllëzimin.

Gjykata i fali besimin ekspertizës, pasi që e njëjta është hartuar në mënyrë profesionale dhe e bazuar në gjendjen e konstatuar në teren dhe fotografive të nxjerra nga gjeoportali i vitit 2012 dhe 2020 me qëllim të krahasimit të ndryshimeve që kanë ndodhur, ashtu që gjykata vlerëson se përmes kësaj ekspertize është vërtetuar në mënyrë të saktë lartësia e dëmit që i padituri ka shkaktuar gjatë mbajtjes në shfrytëzim të tokës pyjore sipas Kontratës Ref.Ke.469/09 i datës 20.07.2009, ashtu që gjykata vlerësoi se paditësi është dëmtuar për vlerën e përgjithshme prej 2,417.07€ dhe atë shumën prej 449.19€ për vlerën e masës drunore, shumën prej 898.38€ për vlerën e humbjes së rritjes (shtimit) vjetor të masës drunore për periudhën 25 vjet dhe shumën prej 1,069.50€ për ripyllëzimin. Andaj, gjykata bazuar në provat e administruara gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar pjesërisht sa i përket shumës në lartësi prej 2,417.07€.

Gjykata refuzoi kërkesëpadinë e paditësit përtej shumës së gjykuar në dispozitivin I të këtij Aktgjykimi, pasi që nga provat e administruara gjykata nuk gjeti se paditësit i është shkaktuar dëm më i lartë sesa dëmi i konstatuar me ekspertizën për vlerësimin e dëmit.

Sipas vlerësimit të gjykatës sipërfaqja reale në të cilën ka pasur pjesërisht dëmtim dhe prerje të drunjëve është më e vogël sesa sipërfaqja e konstatuar nga Raporti i Komisionit të paditësit, pasi

që sipas ekspertizës së vlerësimit të dëmit, sipërfaqja e dëmtuar është më e vogël për 1 ha 28 ari e 70m<sup>2</sup> sesa sipërfaqja e konstatuar nga paditësi në raport, si dhe të dhënat e paraqitura nga paditësi nuk përputhen me gjendjen në teren ashtu që sipërfaqja në të cilën është shkaktuar dëm është konstatuar të jetë sipërfaqja prej 0 ha 71 ari e 30m<sup>2</sup>.

Andaj, meqenëse paditësi me prova të tjera nuk arriti të vërtetoj dëmin përtej lartësisë së vlerësuar me ekspertizë, gjykata refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit në shumë prej 10,376.45€. Nga konstatimet e mësipërme, gjykata përfundimisht vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj të njëjtën e aprovoi sa i përket shumës në lartësi prej 2,417.07€, dhe e refuzoi përtej kësaj shume të gjykuar si në dispozitivin II të këtij Aktgjykimi.

#### *5. Shpenzimet e procedurës*

Lidhur me shpenzimet gjyqësore si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, gjykata vendosi sipas nenit 452 par.1 dhe 2 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e arritur në procedurën gjyqësore, ashtu që vendosi që secila palë të bart shpenzimet e veta procedurale.

Nga të cekurat më lartë, gjykata bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.2596/22, datë 30.05.2024.

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të Aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.